

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Carney pas deklaratës së von der Leyen për anëtare të asociuar: Evropa dhe Kanadaja janë edhe më të forta së bashku - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/carney-pas-deklarates-se-von-der-leyen-evropa-dhe-kanadaja-jane-edhe-me-te-fora-se-bashku/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 10:07:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 10:05:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e7035c518e497fe0a1eb460d397ce0986f766e3fe3cc22077737ae75de966e7
TEKSTI	c604cc37e304bbf75479c2102d35dd4229c1bdf888d51526f16af6f695360ef5
PAMJA	35154819933b2566339a506da37f4fc865953ef21cd15a64a1f31bb86ec0a258

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d220cc3c028e17a44cab3551b85e5d91762dc3e4a94fbe54a2da91f023b67f63
E MËPARSHMJA	7a4d49e3ea81a188b58bb351b3b17638564b1e789f49419d2605cddea72199e3
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d220cc3c028e17a44cab3551b85e5d91762dc3e4a94fbe54a2da91f023b67f63>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Protesta në Tiranë Kuvendi i Shqipërisë BE Gjyqi i UÇK PD

BOTA

Carney pas deklaratës së von der Leyen për anëtare të asociuar: Evropa dhe Kanada janë edhe më të forta së bashku

17 Shtator 2026 | 12:05

Kryeministri i Kanadasë Mark Carney, tha se bashkëpunimi dhe tregtia më e thellë midis Kanadasë dhe Bashkimit Evropian mund të forcojë sovranitetin në të dyja anët e Atlantikut dhe të ndihmojë në krijimin e "rendit të ardhshëm botëror të drejtë, të qëndrueshëm dhe të begatë".

Duke iu drejtuar Parlamentit Evropian në Strasburg të Francës të enjten në mëngjes, Carney bëri një propozim për lidhje më të forta ekonomike me BE-në në industri si inteligjenca artificiale, mineralet kritike dhe mbrojtja.

"Dua të jem i saktë në lidhje me atë që nuk po propozoj. Nuk po propozoj një bllok të tretë për t'u bërë rival i fuqisë së madhe, vetëm me sjellje më të mira", tha Carney.

"Ne nuk kërkojmë pushtet për të dominuar të tjerët. Përkundrazi, ne po kërkojmë qëndrueshmëri në mënyrë që askush të mos mund të kontrollojë tregjet tona të hapura, të dëmtojë sovranitetin tonë, të kërcënojë integritetin tonë territorial ose të minojë liritë tona, demokracitë tona, sundimin tonë të ligjit", shtoi ai.

Fjalimi i Carney-t erdhi ndërsa Kanada dhe BE-ja po shqyrtojnë thellimin e lidhjeve politike, të sigurisë dhe ekonomike. Ky proces filloi në qershor 2025, por është përshpejtuar me zyrtarët kanadezë dhe të BE-së që aludojnë për një partneritet të ri formal të rëndësishëm përtej Marrëveshjes Tregtare Kanada-BE (CETA).

Të mërkurën, Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se po e ftonte Carney-n të "hapte derën" për t'u bërë "anëtar i parë i asociuar" i BE-së, një përcaktim që aktualisht nuk ka bazë në traktatin e bilokut ekonomik dhe politik.

Më vonë atë ditë, Presidenti i SHBA-së Donald Trump tha se nëse Kanada bëhet anëtarja e parë e asociuar e Bashkimit Evropian, kjo mund të jetë një "akt armiqësor".

Duke folur me gazetarët në Karolinën e Veriut, presidenti tha se nëse bëhet me "qëllime të këqija", ai do të "vendosë tarifa shumë të rënda ndaj Evropës".

Trump e quajti gjithashtu Kanadanë një "partner të tmerrshëm tregtar" pasi të mërkurën më herët nënshkroi një memorandum që u drejtonte agjencive federale që mbikëqyrin prokurimin qeveritar në Shtetet e Bashkuara të hiqnin të gjitha produktet me origjinë kanadeze.

LAJMI I FUNDIT

13:55 Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", Gjykata e Tiranës: Detyrim paraqitje për 47-vjeçar

13:53 Nesër, protestë gjithëpopullore në Prishtinë

13:47 Ministria e re Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dorëheqjen

13:45 SHPËRNDAJË
ARTIKULLIN Organizata Botërore Meteorologjike: Viti 2025, një nga vitet më të thata për lumenjtë në dekada

13:42 Plagosën me thikë dy persona pas një sherri, në pranga 3 të rinjtë në Sarandë

13:37 Dronët ruse pranë kufirit ukrainas alarmojnë Poloninë, mbyllen 2 aeroporte dhe ngrihen avionët luftarakë

TESTIM

Emërtimi i mundshëm si “anëtar i asociuar” ka zënë pjesën më të madhe të bisedës politike në Kanada. Por Jonathan Wilkinson, ambasadori i Kanadasë në BE dhe ish-ministër i kabinetit, u tha gazetarëve se Ottawa është më e fokusuar në punën me evropianët për të forcuar partneritetet në sektorë të caktuar.

Ato përfshijnë energjinë dhe burimet natyrore, mineralet kritike, inteligjencën artificiale dhe informatikën kuantike, si dhe prokurimin e mbrojtjes.

Von der Leyen mban fjalimin e 6-të për Gjendjen e Unionit, fton Kanadanë të jetë ‘anëtarja e parë e asociuar’ e BE-së

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA

Organizata Botërore Meteorologjike: Viti 2025, një nga vitet më të thata për lumenjtë në dekada

Organizata Botërore Meteorologjike, OBM ka deklaruar se viti 2025 ishte një nga vitet më të thata në dekada për lumenjtë në të gjithë botën. Më tej ajo...

13:45 | 17/09/2026

BOTA

Dronët ruse pranë kufirit ukrainas alarmojnë Poloninë, mbyllen 2 aeroporte dhe ngrihen avionët luftarakë

Aeroportet në Poloni kanë pezulluar fluturimet për shkak të sulmeve ruse pranë kufirit me Ukrainën perëndimore. Qeveria dërgoi gjithashtu një alarm për një kërcënim sulmi...

13:37 | 17/09/2026

BOTA

Sanksionet e reja të SHBA-së ndaj Rusisë, Kremlini: Do të pengojnë përpjekjet e paqes me Ukrainën

Kremlini njoftoi të enjten se çdo sanksion i mëtejshëm i SHBA-së kundër Rusisë do ta bënte më të vështirë arritjen e një marrëveshjeje paqeje me...

13:26 | 17/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni

Follow Euronews on all platforms: